REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË**
**KRYETARI**

*Tiranë, më 16 qershor 2021.*

Shkëlqesia Juaj, zonja Kryetare Bergkamp,

Me kënaqësi të veçantë mora vesh lajmin e gëzuar që Dhoma e Deputetëve e Vendeve të Ulëta, nën lidershipin Tuaj, i dha dritën jeshile thirrjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare Shqipëri-BE.

Në emër të Kuvendit të Shqipërisë dhe në emrin tim personal, Ju shpreh mirënjohjen për shqyrtimin me kujdes të arritjeve të Shqipërisë drejt plotësimit të rekomandimeve të Komisionit dhe Këshillit Europian.

Fakti që edhe Ju, Komisioni për Çështjet Europiane dhe Dhomës së Deputetëve jeni njohur dhe i keni vlerësuar këto arritje, është një motiv më shumë që Kuvendi, Qeveria dhe institucionet e Shqipërisë t'i shumëfishojnë përpjekjet për të vazhduar rrugëtimin tonë europian, për të arritur dhe për të qëndruar në krah të shteteve anëtare të BE-së me standarte, dinjitet dhe vlera europiane.

Shqipëria do të vazhdojë të avancojë në plotësimin e këtyre standarteve dhe do të bëhet një vlerë e shtuar e Bashkimit Europian, e kësaj familjeje të madhe politike, kulturore dhe njerëzore.

Sinqerisht,

**Gramoz RUÇI**

**Shkëlqesisë së Saj, Zonjës Vera Alida Bergkamp**

**Presidente e Dhomës së Deputetëve**

**Hagë**